

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i Drejtësisë



@ILD_Albania



Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Besimi tek ILD, 300 ankesa nga qytetarët për janar-shkurt 2025

ANKESA MUND TË PARAQITET NË KATËR MËNYRA

1- PËRMES CELULARIT/KOMPJUTERIT

Duke shkuar tek rubrika “Si të ankojem në ILD/Paraqit ankesë”. Klikohet tek “Plotëso formularin online” dhe pasi e merr thjesht e plotëson dhe dërgon direkt edhe përmes celularit/kompjuterit.

Paraqit Ankesë



2- ME EMAIL

Formulari mund të shkarkohet, tek “Shkarko formularin e ankesës”, të plotësohet dhe dërgohet me email në adresën info@ild.al





Besimi tek ILD, 300 ankesa nga qytetarët për janar-shkurt 2025

Fotot e kësaj zyre tregojnë ambientin ku cilave me pretendime, kryesisht për Sektorin e Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun në përmbushje të detyrave mos nisje të gjyqimit të proceseve civile, apo funksionale asistojnë të gjithë qytetarët që penale, si dhe etikën e gjyqtarëve gjatë vijnë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të seancave gjyqësore.

Drejtësisë, duke i orientuar në plotësimin e formularit të ankesës, apo të kërkesës për informacion. Kjo pasi, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, niveli i besueshmërisë së qytetarëve nis që tek pritja dhe komunikimi në institucion.

67 qytetarë që u paraqitën në institucion janë asistuar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përgjatë dy muajve të parë të vitit 2025 nga Sektorin e Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, ndërsa janë informuar përmes telefonit 30 të tjerë.

Në dy muajt e parë të vitit 2025 janë regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rreth 300 ankesa, shumica e të

Prej nisjes së funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vëmendja

Me parimin se një qytetar i informuar arrin të adresojë ku duhet problematikën që has, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, po ndjek një plan komunikimi publik, që nis në institucion, me lehtësitë e krijuara për çdo ankues, përmes faqes së internetit, ku ndodhet një formular i dedikuar për t'u plotësuar, e më tej, çdo ditë, me pritjen dhe asistimin e qytetarëve në një ambient të posaçëm për të gjithë ata që duan të depozitojnë ankesë fizikisht apo të marrin informacion për ecurinë e ankesës së tyre.

ndaj qytetarëve-ankues ka qenë e lartë, si plotësimin e formularit të ankesës dhe një për ata që i janë drejtuar direkt ILD-së, ash-model i plotësuar ankese. Ankesa mund të tu edhe për të tjerë, që ankesat e tyre i kishin depozituar prej vitesh në institucionet paraardhëse, të ngarkuara me procesin disiplinor të magjistratëve. së ankesëve.

Me parimin se një qytetar i informuar arrin të adresojë ku duhet problematikën që has, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, po ndjek një plan komunikimi publik, që nis në institucion, me lehtësitë e krijuara për çdo ankues, përmes faqes së internetit, ku ndodhet një formular i dedikuar për t'u plotësuar, e më tej, çdo ditë, me pritjen dhe asistimin e qytetarëve në një ambient të posaçëm për të gjithë ata që duan të depozitojnë ankesë fizikisht apo të marrin informacion për ecurinë e ankesës së tyre.

Në faqen e internetit, në pozicion të dukshëm ndodhet seksioni "si të ankojmë në ILD", brenda të cilit tregohen mënyra e ankimit, rregullat që e bëjnë të pranueshme një ankesë, si dhe një udhëzues për




ANKESA MUND TË PARAQITET NË KATËR MËNYRA

1- PËRMES CELULARIT/KOMPJUTERIT

Duke shkuar tek rubrika “Si të ankoem në ILD/Paraqit ankesë”. Klikohet tek “Plotëso formularin online” dhe pasi e merr thjesht e plotëson dhe dërgon direkt edhe përmes celularit/kompjuterit.

Paraqit Ankesë



2- ME EMAIL

Formulari mund të shkarkohet, tek “Shkarko formularin e ankesës”, të plotësohet dhe dërgohet me email në adresën info@ild.al



1. Ankimi mund të bëhet online, duke shkuar tek rubrika “Si të ankoem në ILD/Paraqit ankesë”. Klikohet tek “Plotëso formularin online” dhe pasi e merr thjesht e plotëson dhe e dërgon direkt përmes celularit.
2. Ekziston edhe opsioni që formulari të shkarkohet, tek “Shkarko formularin e ankesës”, të plotësohet dhe dërgohet me e-mail në adresën info@ild.al
3. Formulari i shkarkuar i plotësuar mund të dërgohet me postë në adresën e institucionit.
4. Për ata që kanë nevojë për ndihmë për ta plotësuar, formulari mund të plotësohet fizikisht pranë ILD-së, me asistencën e Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, që pret çdo ditë qytetarë të interesuar në institucion.

3- ME POSTË

Formulari i shkarkuar e plotësuar mund të dërgohet me postë në adresën e institucionit.



4- FIZIKISHT NË ILD

Për ata që kanë nevojë për ndihmë për ta plotësuar, formulari mund të plotësohet fizikisht pranë ILD-së, me asistencën e Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, që pret çdo ditë qytetarë të interesuar në institucion.



Procesi i asistuar nga
-Stafi ILD-

KATËR MËNYRAT E ANKESËS GRAFIKISHT

ANKESA MUND TË PARAQITET NË
KATËR MËNYRA

◦ 1- PËRMES CELULARIT/KOMPJUTERIT

Duke shkuar tek rubrika “Si të ankojem në ILD/Paraqit ankesë”. Klikohet tek “Plotëso formularin online” dhe pasi e merr thjesht e plotëson dhe dërgon direkt edhe përmes celularit/kompjuterit.




◦ 3- ME POSTË

Formulari i shkarkuar e plotësuar mund të dërgohet me postë në adresën e institucionit.



◦ 2- ME EMAIL

Formulari mund të shkarkohet, tek “Shkarko formularin e ankesës”, të plotësohet dhe dërgohet me email në adresën info@ild.al



◦ 4- FIZIKISHT NË ILD

Për ata që kanë nevojë për ndihmë për ta plotësuar, formulari mund të plotësohet fizikisht pranë ILD-së, me asistencën e Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, që pret cdo ditë qytetarë të interesuar në institucion.



Procesi i asistuar nga
-Stafi ILD-

KRITERET PËR PRANUESHMËRINË E ANKESËS NË ILD

Në seksionin e ankesës shpjegohen edhe kërkesat që parashikon ligji, që ankesa të jetë e pranueshme, bashkë me shembuj konkretë orientues për çdo ankues. Sipas ligjit shqyrtimi për pranueshmëri ka të bëjë me verifikimin e informacionit lidhur me:

- **Mënyrën e paraqitjes**, pra nëse ankesa është e paraqitur me shkrim;
- **Të dhënat** si emri, mbiemri dhe adresa e ankuesit;
- **Përshkrimin** e fakteve dhe rrethanave për të cilat bëhet ankesa;
- **Emrin, mbiemrin** e gjyqtarit apo prokurorit, bashkë me gjykatën apo prokurorinë ku ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur rrethana apo fakti ndaj të cilit bëhet ankesa;
- **Shkelja** e pretenduar ka ndodhur brenda 5 viteve nga momenti i dorëzimit të ankesës;
- Në përmbajtje të ankesës **nuk ka elemente abuzive**, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues;
- **Sjellja e magjistratit**, i cili ka qenë në detyrë në kohën, kur ka ndodhur rrethana apo fakti për të cilën bëhet ankesa;
- **Sjellja e magjistratit** e parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
- **Sjellja e magjistratit** që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

Vetëm pasi plotësohen të gjitha këto kushte, ankesa pranohet dhe vijohet me procedurat e verifikimit të pretendimeve të ngritura në ankesë. Nëse njëri prej ose më shumë nga kriteret e përcaktuara më sipër nuk plotësohen, atëherë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nxjerr vendimin për arkivimin e ankesës. Ankuesi njoftohet për vendimin e arkivimit të ankesës dhe për të drejtën e tij për t'u ankuar, ndaj vendimit, bashkë me afatin brenda të cilit mund të kryhet kjo ankesë.

KRITERET PËR PRANUESHMËRINË PARAQITUR GRAFIKISHT

KRITERET PËR PRANUESHMËRINË E ANKESËS NË **ILD**

Forma e ankesës:
Duhet të jetë e paraqitur me shkrim.



Të dhënat e ankuesit:
Përfshin emrin, mbiemrin dhe adresën e plotë.

Përshkrimi i fakteve:
Duhet të përmbajë rrethanat për të cilat bëhet ankesa.



Identiteti i gjyqtarit/prokuratorit
Të përfshijë emrin, mbiemrin dhe institucionin ku ka shërbyer në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar.

Afati ligjor:
Shkelja duhet të ketë ndodhur brenda 5 viteve nga dorëzimi i ankesës.



Pa elemente abuzive/përsëritëse:
Ankesa nuk duhet të jetë haptazi e pabazuar ose përsëritur nga i njëjti ankues.

PËR ÇFARË DHE NDAJ KUJT MUND TË BËHET ANKESË NË ILD?

Për çfarë mund të bëhet ankesë në ILD? ⇒ Sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.

⇒ Veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mos përbushje të detyrës;

PËR ÇFARË MUND TË BËHET ANKESË NË ILD?

✓ VEPRIME OSE MOSVEPRIME QË PËRBËJNË MOS PËRMBUSHJE TË DETYRËS.

✓ SJELLJE JOPROFESIONALE OSE JOETIKE QË DISKREDITOJNË FIGURËN E MAGJISTRATIT.

Ndaj kujt bëhet ankesë në ILD?

⇒ Ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjitha niveleve në Republikën e

Shqipërisë, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e Prokurorit të Përgjithshëm.

NDAJ KUJT MUND TË BËHET ANKESË NË ILD?

✓ GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË TË GJITHA NIVELEVE.

✓ ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË.

✓ PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM.

PËR ÇFARË DHE NDAJ KUJT MUND TË BËHET
ANKESË NË ILD? (GRAFIKISHT)

PËR ÇFARË MUND TË BËHET ANKESË NË **ILD?**

- ✓ VEPRIME OSE MOSVEPRIME QË PËRBËJNË MOS PËRMBUSHJE TË DETYRËS.
- ✓ SJELLJE JOPROFESIONALE OSE JOETIKE QË DISKREDITOJNË FIGURËN E MAGJISTRATIT.

NDAJ KUJT MUND TË BËHET ANKESË NË **ILD?**

- ✓ GJYQ TARËVE DHE PROKURORËVE TË TË GJITHA NIVELEVE.
- ✓ ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË.
- ✓ PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM.

3 MËNYRAT PËR TË KOMUNIKUAR THJESHT E SHPEJT ME ZYRËN E ILD

🔑 TRI MËNYRA TË THJESHTA DHE TË SHPEJTA PËR TË KOMUNIKUAR ME ZYRËN E **ILD-SË**:

✉ **ME EMAIL** - DËRGONI ANKESAT/DOKUMENTET OSE KËRKONI INFORMACION NË **INFO@ILD.AL**. KJO ËSHTË NJË MËNYRË E SHPEJTË DHE E LEHTË PËR TË KOMUNIKUAR ME NE.

☎ **ME TELEFON** - PËR NJË KOMUNIKIM TË DREJTPËRDREJTË NË KOHË REALE, MUND TË NA KONTAKTONI NË NUMRIN ZYRTAR TË TELEFONIT. KJO SIGURON TË DREJTËN PËR INFORMIM PËR PUBLIKUN, INSTITUCIONET DHE QYTETARËT E INTERESUAR.

🏢 **PARAQITJE FIZIKE** - NA VIZITONI PERSONALISHT ÇDO DITË PUNE NGA ORA 09:00 DERI NË 14:00 NË ZYRËN E ILD-SË.

Tri janë mënyrat për të komunikuar thjesht e shpejt me Zyrën e ILD-së:

⇒ Me postë elektronike tek info@ild.al, si mënyrë e shpejtë komunikimi për dërgimin e ankesave/dokumenteve, apo për të kërkuar informacion;

⇒ Numri zyrtar i telefonit, për një komunikim në kohë reale me publikun, institucione e qytetarë të interesuar, një nga mënyrat për të garantuar të drejtën për informim.

⇒ Paraqitja fizike në ILD, çdo ditë pune nga ora 09.00 deri në orën 14.00.

Krahas faqes zyrtare, informimi i publikut bëhet edhe përmes llogarive të ILD në rrjetet sociale Twitter, Facebook dhe kanalit Youtube.





7,027+

Ankesa të konfirmuara

5,742

Ankesa të trajtuara

1,285

Ankesa në proces trajtimi

132

Magjistratë të hetuar

168

Ankesa në proces verifikimi
pas shqyrtimit fillestar

45

Kërkesa për procedim
disiplinor

Ky informacion rifreskohet çdo të hënë

Në funksion të transparencës, në faqen e ILD-së, çdo të hënë vijon të publikohet ecuria javore e punës në ILD, sa i takon përpunimit javor të ankesave të admin-

istruara, atyre të trajtuara, atyre në proces trajtimi fillestar, verifikimi, arkivimi, hetimet dhe procedimet disiplinore.

EDUKIMI LIGJOR DHE VJELJA E OPINIONIT PUBLIK

Në 5 vite funksionim, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka krijuar një traditë të mirë në drejtim të edukimit ligjor, për misionin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrës së ILD-së, përmes bashkëbisedimeve me grupe të ndryshme shoqërore, si mënyrë për të marrë edhe perceptimin publik mbi punën e institucionit, por edhe dinamikat që përcjell sistemi përmes eksperiencave të ndryshme.

Anketa e ILD-së vijon të jetë një mënyrë direkte për të vjelë opinione mbi punën e ILD-së, çfarë bëhet mirë e çfarë duhet përmirësuar për të rritur efikasitetin e punës. (foto anketa) dhe kjo reflektohet, edhe tek plotësimet që i bëhen faqes së internetit, që është dy gjuhëshe, shqip dhe anglisht.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË MIKPRITI KLASËN 2025 TË PROGRAMIT LEAD ALBANIA

Në vijim të një tradite të krijuar tashmë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mikpriti sot në ambientet e institucionit të ILD-së klasën e vitit 2024-2025 të programit LEAD Albania, të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.

Në nisje të bashkëbisedimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njohu pjesëmarrësit me rolin dhe funksionet e ILD-së, si institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve,

anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Më tej z. Metani iu përgjigj interesimit të tyre mbi aspekte të punës së institucionit, që nga marrja e ankesave të qytetarëve a institucioneve, shqyrtimi e verifikimi i tyre, hetimi disiplinor e procedimi, si dhe inspektimet tematike e institucionale.

Pjesëmarrësit e programit një vjeçar LEAD Albania, janë profesionistë të rinj, të shkolluar brenda e jashtë vendit, të cilët



përmes kësaj eksperience, kanë mundësinë e përvojës së drejtpërdrejtë në procesin e qeverisjes, përmes angazhimit për një vit, si pjesë e kabineteve të institucioneve më të larta shtetërore në

vend, në rastin e klasës 2025, pranë kryeministrisë, ministrive të ndryshme, e deri tek institucione të drejtësisë, si Këshilli i Lartë Gjyqësor.



NGA VIZITA E KLASËS SË VITIT 2024-2025 TË PROGRAMIT LEAD ALBANIA



SHKURTI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **shkurt 2025** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **155 ankesa vetëm nga qytetarë**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit shkurt 2025.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
<p>47 vendime nga 88 praktika të trajtuara</p> <ul style="list-style-type: none"> • 20 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar; • 23 vendime arkivimi pas verifikimit; • 4 vendime përfundim procedure verifikimi pa një vendim përfundimtar 	<ul style="list-style-type: none"> • 4 vendime verifikimi 	<ul style="list-style-type: none"> • 2 vendime për përfundim hetimi disiplinor për tre magjistratë (gjyqtarë) • 1 vendim fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat (prokuror) • 1 kërkesë për procedim disiplinor për 1 magjistrat (gjyqtare)

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD,

në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Shkurt** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **5 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit Shkurt 2025, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun:

- ⇒ ka pritur **50** ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- ⇒ ka realizuar **20** telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: **info@ild.al**, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit **Shkurt 2025**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **18 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ILD NË TWITTER




Inspektori i Larte i Drejtesise Artur M...

@ILD_Albania

- 📍 Përpunimi javor i ankesave #ILD ⚖️
- ✅ 6926 të konfirmuara
 - ✅ 5707 të trajtuara
 - ✅ 1219 në proces trajtimi
 - ✅ 186 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar
 - ✅ 131 magjistratë të hetuar
 - ✅ 45 kërkesa për procedim disiplinor
- ? Keni pasur eksperiencë me ne? 🙋
- ild.al/sq/ankete/

Translate post



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur M...

@ILD_Albania

Kënaqësi të bashkëbisedoja hapur e në nivel profesional me pjesëmarrësit e programit @LEADAlbania, profesionistë të talentuar me dëshirë për të kontribuar për vendin. #ILD ⚖️

@The_AADF 🇷🇪 🇺🇸 🇹🇷

Translate post



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË MIKPRITI KLASËN 2025...


From ild.al



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur M...

@ILD_Albania


- 📍 Përpunimi javor i ankesave #ILD ⚖️
- ✅ 6872 të konfirmuara
 - ✅ 5695 të trajtuara
 - ✅ 1177 në proces trajtimi
 - ✅ 190 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar
- 🙋 Më shumë ild.al
- ? Keni pasur eksperiencë me ne? Na shkruani 🙋 🙋
- ild.al/sq/ankete/



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur M...

@ILD_Albania

- Përpunimi javor i ankesave #ILD ⚖️
- ✅ 6968 të konfirmuara
 - ✅ 5716 të trajtuara
 - ✅ 1252 në proces trajtimi
 - ✅ 182 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar
- 🙋 Më shumë ild.al
- ? Si mund të ankojem në ILD? 🙋 🙋
- ild.al/sq/si-pranohen...



SHKURT 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara


© ILD

**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin
prezantues të ILD*



Më skano!